



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.201 dt.24.12.1998

**CELJE FONDI NGA TE ARDHURAT E BASHKISE SE TIRANES  
PER BOTIMIN E GAZETES "GAZETA BASHKIAKE"  
PER 12 NUMRAT E VITIT 1999.**

Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot me dt.24.12.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra e Shtypit, "Për miratimin e fondit për nxjerrjen e gazetës "Gazeta Bashkiake" për vitin në vazhdim", mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993, "Për buxhetin lokal" si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.177, dt.27.11.1997, "Mbi botimin e gazetës "Gazeta Bashkiake" e Tiranës.

**V E N D O S I**

1. Të miratojë fondin prej 240.000 lekë nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për botimin e gazetës "Gazeta Bashkiake" për 12 numra të vitit në vazhdim 1999.  
1.Gazeta të shpërndalet pa interes fitimi.
2. Në strukturën e organikës së punonjësve të Bashkisë emërtimi "Specialist për shtypin" të zëvendësohet me emërtimin "Kryeredaktor i gazetës".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Drejtoria Juridike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**